

V E N D I M
Nr. 5, datë 5.1.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.197, DATË 18.3.1996 “PËR RRJETIN E INSTITUCIONEVE SHKENCORE SHTETËRORE”

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, në lidhjen I të hiqet Instituti Energjitik (IE) - Tiranë.
 2. Instituti Energjitik (IE) Tiranë transformohet si njësi studimore dhe projektuese brenda strukturave të sh.a. KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 25, datë 5.1.1998

PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË STREHIMIT TË 24 FAMILJEVE TË FSHATRAVE QË PËRMBYTEN NGA UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS, TË CILAT JANË PARASHIKUAR TË SISTEMOHEN NË QYTETIN E TIRANËS

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe me kërkesën e komunës së Zall Bastarit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komunës së Zall Bastarit i miratohet fondi prej 32.138 mijë lekësh për kryerjen e pagesave të 24 familjeve të fshatrave që përmbysten nga ujëmbledhësi i Bovillës, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi, për blerjen nga ana e tyre të banesave në qytetin e Tiranës.
 - Kryerja e pagesave të bëhet pas lëshimit të një deklarate nga të gjithë pjesëtarët madhorë të këtyre familjeve, me të cilën të deklarojnë se nuk kanë kundërshtim me kompensimin dhe se e konsiderojnë të zgjidhur çështjen e strehimit të tyre.
 - Largimi i këtyre familjeve të bëhet 20 ditë pas kryerjes së pagesës.
 2. Fondet e mësipërme përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, nga fondet e vitit 1997 të veprës “Ujëmbledhësi i Bovillës”.
 3. Familjet që trajtohen me këtë vendim, përjashtohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 19.5.1995 “Për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të fshatrave Zallmner, Bulçesh dhe Brurëz”.
 4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Rrethit të Tiranës, Bashkia e Tiranës dhe komuna e Zall Bastarit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E KRYEFAMILJARËVE PËR 24 FAMILJET QË JANË PARASHIKUAR TË SISTEMOHEN NË QYTETIN E TIRANËS NGA FSHATRAVE QË PËRMBYTEN NGA UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS

Për fshatin Zall-Mner				
1	Xhevahir Lushi	2	1+1	1.210
2	Avdi Gega	5	3+1	1.758
3	Agim Tafa	2	1+1	1.210
4	Agim Lami	3	1+1	1.210
5	Lulzim Lila	3	1+1	1.210
6	Agron Lami	2	1+1	1.210
7	Ismail Lami	4	3+1	1.758
8	Bajram Hyseni	3	1+1	1.210
9	Xhavit Ademi	6	3+1	1.758
10	Hasan Gega	4	2+1	1.512
11	Selim Abazi	5	2+1	1.512
12	Asim Ademi	2	1+1	1.210
			Shuma	a:16.764

Për fshatin Bulcesh				
1	Ibrahim Cali	3	1+1	1.210
2	Hava Cali	2	1+1	1.210
3	Murat Cali	6	3+1	1.758
4	Astrit Sala	2	1+1	1.210
5	Islam Loka	2	1.+1	1.210
6	Haxhi Vogli	3	1+1	1.210
7	Ismail Muça	2	1+1	1.210
8	Qazim Hoxha	2	1+1	1.210
9	Pëllumb Popshini	2	1+1	1.210
10	Haxhie Dajti	2	1+1	1.210
11	Nazmi Koçi	5	2+1	1.512
12	Bihane Bruzi	1	1+1	1.210
			Shuma b:15.370 b	Shuma
				a+b=32.134

Shënim: Këto familje janë dakord për të marrë lekët në dorë, sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave, dhe lejet t'u jepen brenda vitit 1997, për blerjen e shtëpive, dërguar nga komuna Zall-Bastar me shkresën nr. 205, datë 10.7.1997, nga komuna Zall-Bastar, Tiranë.